



Pranimi / Datozimi / Prilazimi / Prilaziti / Received / Doherty	06.05.2022	2	viti / god / year
Organ / Detyra / Organ / Detyra / Org / Unit	Nr. Prof. / Nr. Prof. / Prof. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKOMBEX	2655/2022		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.285/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.285/2022 të datës 24.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi,

kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.285/2022 e datës 24.03.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.nr.004/2022 i datës 11.03.2022, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, konkretisht pika I e këtij vendimi lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën II të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi është punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas akt emërimit të datës 20.11.2018 në pozitën "Udhëheqës i sektorit për operativë dhe siguri". Me datën 14.10.2020 Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerrë vendimin me numër 0893, sipas të cilit ankuesi është caktuar përkohësisht në pozitën e "Udhëheqësit të drejtoratit për operativ, siguri dhe transportim të burgosurve".

Me datën 04.02.2022 ,përmes e-mailit zyrtar Zëvendësuesi i zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka parashtruar kërkesë tek anëtarët e komisionit disiplinor, që të iniciojnë procedurën disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës lidhur me vendosjen e kamerave tek dhomat me rastet e rënda psikiatrike.

Komisioni Disiplinor me datën 11.03.2022 ka nxjerrë vendimin me numër KD.nr.004/2022, sipas të cilit ankuesin e ka gjetur përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi 20% e pagës për periudhë një muaj".

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër KD.nr.004/2022 të datës 11.03.2022 të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, si dhe vendimin me nume të protokollit 0265 të datës 04.03.2022 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 24.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1569/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore materiale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 04.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datën 19.04.2022, ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 2218/2022, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.prot:1569/2022 të datës 24.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 24.02.2022 përmes e-mailit zyrtar; E-mailin zyrtar të datës 28.02.2022; Vendimin me numër KD.nr.004/2021 të datës 04.02.2022; Ftesën e datës 16.02.2022; Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Raportin mujor të punës nga drejtoritë e burgjeve për periudhën 01.01.2022 janar deri më 31.01.2022; Urdhëresën e datës 26.01.2022; Shkresën zyrtare të datës 06.02.2022 lidhur me formën për raportimin e incidentit; E-mailin zyrtar të datës 04.02.2022 lidhur me njoftimin për rastet psikiatrike në QKFL; e-mailin zyrtar të datës 14.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 12.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 28.01.2022; E-mailat zyrtar të datës 18.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 28.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 18.01.2022; Raportin me numër 244/2022 të datës 24.02.2022 nga institucioni i Avokatit të Popullit; E-mailat zyrtar të datës 25.01.2022; Raportin e hetimit me numër 0255 të datës 02.03.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Vendimin me numër 0145 të datës 14.02.2022 nga zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër 004 të datës 04.03.2022 të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor; Vendimin me numër 0265 të datës 04.03.2022 nga zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër 0893 të datës 14.10.2020 nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.004/2022 të datës nga Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit të datës 06.12.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 19.04.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të

punës së ankuesit të datës 01.08.2014; Vendimin me numër 0139 të datës 11.02.2022; Fletëkthesën e datës 15.03.2022; E-maili zyrtar i datës 29.04.2022 lidhur me provat shtese nga organi i punësimit. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, **SEPSE:**

Me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafin 1 është përcaktuar se: *“Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”*, nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe legjislacionit të veçantë.

Po ashtu Kolegji, me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka marrë parasysh specifikat e institucionit sikurse edhe çështjen e legjislacionit të veçantë i përcaktuar si në nenin 4 paragrafin 2 nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përcaktohet se: *“Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, fillimisht ka analizuar raportin e datës 24.02.2022 i hartuar nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me instalimin e kamerave të sigurisë në disa qeli të të burgosurave në Qendrën Korrektuese në Lipjan në të cilin theksohet se citoj: *“Gjatë vizitës zyrtarët e Avokatit të Popullit, kane vërejtur se në disa qeli janë instaluar kamera të sigurisë në të cilat vendosen të burgosurat me gjendje të rëndë të shëndetit mendor, të cilat në parim do të duhej të trajtoheshin në institucione adekuate shëndetësore. Në rastin në fjalë, zyrtarët e Avokatit të Popullit, kane vërejtur se kamerat e sigurisë mbulonin vetëm shtretërit dhe dritaret e qelive, nuk mbulonin tualetet, dushet dhe lavamanin. Gjatë vizitës, zyrtarët e Avokatit të Popullit, u njoftuan se arsyeja e instalimit të kamerave të sigurisë në këto qeli ishte mbrojtja e të burgosurave të cilat përbëjnë rrezik për vetëlëndim apo vetëvrasje për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore”*, ndërsa në fund të raportit ka rekomanduar që të miratohet një akt nënligjor konkret i cili do të përfshinte të gjitha garancitë procedurale të parapara me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Ndërlidhur me këtë Kolegji, ka konstatuar se me datën 14.02.2022 zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka nxjerrë vendim lidhur me lejimin e instalimit të sistemit të kamerave të sigurisë në objektet e institucioneve korrektuese vetëm në hapësirat e jashtme dhe në hyrje të pavijoneve në institucionet korrektuese, përjashtimisht kamerat vëzhguese ka theksuar se mund të instalohen në dhoma të veçanta të dedikuara për raste specifike, për të burgosur me probleme të shëndetit mendor sipas rekomandimit të mjekut të institucionit për vëzhgim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka analizuar raportin e hetimit të datës 02.03.2022 të hartuar nga komisioni hetimor i Shërbimit Korrektues të Kosovës në lidhje me

instalimin e kamerave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan dhe në lidhje me rastin e ankuesit ka konstatuar se tek gjetjet e këtij raporti është përfshirë edhe konstatimi në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të zyrtarëve përgjegjës të këtij institucioni, ku decidivisht theksohet se citoj : *“Kamerat e sigurisë janë vendosur dhe instaluar nga mbikëqyrësi për Siguri zyrtari korrektues dhe mirëmbajtësi me rekomandim të drejtoreshës si dhe i njëjti ka rekomanduar që të vendos lidhur me përgjegjësinë disiplinore të zyrtarëve, e që në bazë të provave dhe fakteve del se për rastin konkret emri i ankuesit nuk përmendet askund në këtë raport si zyrtar përgjegjës në lidhje me instalimin e kamerave të sigurisë ose se i njëjti ka dhënë urdhër për instalimin e tyre. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ndërlidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit ka analizuar edhe nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”* dhe ka konstatuar se bazuar në raportin hetimor të sipër theksuar, i hartuar nga komisioni hetimor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, del se për rastin e ankuesit nuk është vërtetuar saktë ndonjë veprim i paligjshëm që është ndërmarrë nga ana e tij në lidhje me instalimin e kamerave të sigurisë ,mirëpo përkundrazi Kolegji vlerëson se pas analizimit të e-mailit zyrtar të datës 25.01.2022, ku zyrtari sqaron situatën ankuesit në lidhje me atë se kanë qenë të detyruar të ndërmarrin masa të sigurisë për vëzhgimin e rasteve për të burgosurat dhe se të njëjtin e pyet se a është e nevojshme që në dhomat ku i kemi të vendosura të burgosurat me kamera të vëzhgohen edhe fizikisht nga zyrtarja korrektuese, ankuesi me rastin e kthimit të përgjigjes po me datën 25.01.2022 përmes -e-mailit zyrtar kërkon nga po ky zyrtar që të sigurohet mirëqenia fizike e të burgosurve e që përveç vëzhgimit permanent në sistemin e CCTV, zyrtari përgjegjës duhet të regjistroj në formular kohën e caktuar të vëzhgimit pasi që ky formular dëshmon që zyrtari ka bërë vëzhgimin sipas rekomandimit për mbikëqyrje të shtuar sipas përcaktimit nga ana e mjekut.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar edhe vendimin e komisionit disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ku për rastin e ankuesit ka elaboruar veprimet përgjegjëse të ankuesit ndërlidhur me rastin e instalimit të kamerave të sigurisë në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan dhe ka konstatuar se po në këtë vendim është elaboruar përgjegjësia disiplinore lidhur me vendosjen e këtyre kamerave, e që kjo përgjegjësi bie direkt tek zëvendësuesja e Drejtorit në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan e cila ka lejuar vendosjen e këtyre kamerave, prandaj edhe masa e shqiptuar ndaj ankuesit nuk është masë e cila është shqiptuar në proporcion me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit dhe me rastin e shkeljes së rëndë të detyrave të punës siq përcaktohet me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku thuhet se: *“1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”* ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”*, nga ku rrjedh se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore *“Ndalimi 20% e pagës për periudhë një muaj”*, për ankuesin, nuk i ka marrë për bazë provat dhe faktet lidhur me mos përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, nuk i ka marrë për bazë veprimet që kanë të bëjnë me individualizimin e përgjegjësisë që lidhet me këtë masë, po ashtu duke pasur parasysh edhe veprimet e tjera të mëhershme, andaj bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë, pretendimet e ankuesit lidhur me mos

përgjegjësinë disiplinore lidhur me këtë rast janë të bazuara në ligj dhe njëkohësisht të qëndrueshme.

Kolegji po ashtu thekson faktin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.004/2022 të datës 11.03.2022 u ka shqiptuar masa të ndryshme disiplinore tre (3) zyrtarëve të cilët i ka gjetur përgjegjës për rastin e lart cekur, ndërsa aprovimi i pjesërishëm i ankesës së ankuesit të datës 24.03.2022 lidhur me shfuqizimin e vendimit të Komisionit Disiplinor me numër KD.nr.004/2022 të datës 11.03.2022, ka të bëjë vetëm me pikën I të dispozitivit, ku përcaktohet në mënyrë taksative masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit dhe i njëjti i pakënaqur me këtë masë ka iniciuar procedurën administrative me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, andaj meqenëse ankesa ka qenë individuale, Kolegji konstaton se në këtë rast nuk mund të lëshohet përtej kompetencave dhe ka vendosur vetëm për rastin e ankuesit

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me atë se Vendimi me numër 0893 i datës 14.10.2020, lidhur me emërimin e tij në pozitën e zëvendësuesit të Udhëheqësit të Drejtoratit për Siguri dhe Operativë është shfuqizuar nga zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se është kompetencë e organit të punësimit lidhur me caktimin e nëpunësve në pozita me zëvendësues të detyrës për periudhën e përcaktuar ligjore, bazuar në nenin 32 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, andaj edhe pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me kthimin e tij në këtë pozitë të mëhershme është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.285/2022, datë 06.05.2022

Ardita Percuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së